



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.60/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. [] si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e quajtur Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [] i dyshuar për shkelje disiplinore gjatë veprimeve përmbarimore në çështjen përmbarimore P. nr 742/20, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i Kompanisë [], sipas autorizimit, palës ankuese z. Levent Abazi, dhe përmbaruesit privat, z. [] dhe pas seancës këshillimore, me datën 28.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL. Nr. 60/2021, datë 14.12.2021, raporti i Ministrisë së Drejtësisë – Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, datë 06.12.2021, dhe ankesa e palës ankuese, përfaqësuesit të Kompanisë [] të datës 09.07.2021, si të pa bazuara.
- II. Ndaj Organit përmbaruesit - Përmbaruesit Privat, z. [] është zbatuar procedura disiplinore lidhur me veprimet e tij në lëndën përmbarimore P. Nr 742/2020 dhe pretendimet e ngritura për shkelje disiplinore në të njëjtën lëndë përmbarimore përbëjnë çështje të gjykuar.

A R S Y E T I M

Me datën 09.07.2021, pala ankuese ka paraqitur një ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira, Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. [] Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat z. []

ka bllokuar llogaritë rrjedhëse të kompanisë në muajin janar 2021, ka tërhequr nga llogaria mjetet dhe ka rezervuar në llogari të bankës deri në vendimin e Gjykatës. Bllokimi i llogarive sipas palës ankuese ka ndodhur pa paralajmërim paraprak, kompania nga Serbia iu ka dëmtuar atyre mallin dhe rrjedhimisht ata nuk kanë asnjë obligim ndaj kompanisë. Po ashtu, pala ankuese thekson se ata kanë hasur në pengesa në regjistrimin e automjetit të kompanisë. Rrjedhimisht, pala ankuese thekson që përmbaruesi privat z. ka kryer shkelje thelbësore të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, parimeve themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe shkelje të Kodit të Përkohshëm të Etikës së Përmbaruesve Privat.

Me datën 06.12.2021, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira ka përgatitur raportin e inspektimit të veçantë përkitazi me lëndën përmbarimore P. nr 742/2020. Raporti thekson që faturat (650/19 dt 17.07.2021, 944/19 dt 22.10.2021) të paraqitura si objekt i fillimit të procedurës përmbarimore në urdhrin përmbarimor P. nr 742/20 janë të nënshkruara vetëm nga ana e kreditorit (). Po ashtu, raporti thekson që tarifat e shpenzimeve të përmbaruesit privat z. janë tejkualuar duke qenë në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 4 të nenit 352 dhe 353 të LPP-së. Sipas raportit, urdhri për bllokimin e llogarive, pasqyra për llogaritjen e kamatës dhe pasqyra e shpenzimeve të procedurës përmbarimore janë nxjerrë në të njëjtën datë 11.01.2021. Në fund, raporti thekson që përmbaruesi privat z. ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP sepse me datën 09.07.2021 është nxjerrë urdhëresa për transferin e mjeteve monetare nga debitori në llogari të përmbaruesit privat dhe në të njëjtën datë është nxjerrë edhe konkluzioni që lënda është çështje e përfunduar e po ashtu është bërë edhe deblokimi i llogarive bankare të debitorit, ndërkaq përkundër faktit se mjetet monetare janë tërhequr nga llogaria bankare e debitorit, përmbaruesi privat nuk i liron nga ndalesa edhe dy veturat në emër të palës debitore të bllokuara për regjistrim në ARC, Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Me datën 28.01.2022, lidhur me këtë rast, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancën dëgjimore publike në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i Kompanisë sipas autorizimit, pala ankuese z. si dhe përmbaruesi privat, z.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se mbetet pranë tij. Po ashtu edhe përfaqësuesi e palës ankuese ka ngelur pranë ankesës së paraqitur me shkrim si dhe ka bërë eleborimin e saj.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij gjatë seancës dëgjimore deklaroi që ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore dhe se nuk ekzistojnë pretendimet e ngritura për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se ndaj përmbaruesit privat z. është zbatuar procedura disiplinore lidhur me veprimet e tij në lëndën përmbarimore P. Nr 742/2020 dhe pretendimet e ngritura për shkelje disiplinore në të njëjtën lëndë përmbarimore përbëjnë çështje të

gjykuar. Konkretisht, Komisioni Disiplinor ka adresuar pretendimet për shkelje disiplinore në vendimin DPL . nr 01/2021. Rrjedhimisht, shkeljet e pretenduara disiplinore të cilave i referohet pala ankuese lidhen pikërisht me veprimet e përmbaruesit privat z. në lëndën përmbarimore P. nr 742/2020, të cilat tashmë kanë qenë një herë objekt shqyrtimi dhe janë trajtuar nga ana e Komisionit Disiplinor. Siç e ka theksuar edhe vet pala ankuese, e njëjta ka ushtruar Padi në procedurën e Konfliktit Administrativ kundër vendimit të Komisionit Disiplinor DPL. Nr 01.2021. Çështja tashmë është në shqyrtim pranë gjykatës kompetente. Në dritën e kësaj, Komisioni Disiplinor është i kufizuar që të bëjë ndonjë vlerësim të pretendimeve të palës ankuese të cilat tashmë janë trajtuar.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL. nr 60/2021, datë 28.01.2022

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.



ADMINISTRATIVE ORDER NO. 1200
ISSUED ON 12/20/74

DEPARTMENT OF HEALTH

SECRET